



# Gjykata Supreme e Kosovës

**Raporti i punës për vitin  
2012**

---

## Ligji për gjykatat

Ligji nr. 03/L-199 për gjykatat, parasheh një transformim të tërësishëm të gjykatave, që do të fillojë të zbatohet nga Janari i vitit 2013.

Gjykata Supreme nuk do të ndryshojë në strukturë dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme nuk do të preken gjatë fazës implementuese të ligjit për gjykatat.

Sipas ligjit të ri për gjykatat, Gjykata Supreme do të merret me mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Me amandamentin që i është shtuar këtij ligji, kjo gjykatë do të vazhdojë të merret edhe me ankesat penale të shkallës së tretë (API). Gjithashtu, Gjykata Supreme do të merret me qëndrime parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorit të Republikës së Kosovës.

## Zgjidhja e lëndëve të pakryera<sup>1</sup>

Të gjitha lëndët të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013 trajtohen si lëndë të Gjykatës së Apelit.

Të gjitha lëndët të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së parë të Gjykatës Supreme dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013 trajtohen si lëndë të Gjykatës Themelore, e cila ka juridiksionin territorial përkatës.

## Vlefshmëria e vendimeve të mëparshme të formës së prerë dhe e drejta në ankesë<sup>2</sup>

Të gjitha vendimet e formës së prerë të Gjykatës Supreme të nxjerra para transferimit të kompetencave tek gjykatat e themeluara me këtë ligj, do të kenë fuqi dhe efekt të plotë.

<sup>1</sup> Ligji nr.03/L-199 për gjykatat, neni 39.

<sup>2</sup> Ligji nr.03/L-199 për gjykatat, neni 40.

## Raporti i punës së Gjykatës Supreme të Kosovës

Nga Janari i vitit 2013, Gjykata Supreme në bazë të ligjit të ri për gjykatat, do të merret me lëndë të këtij karakteri:

REGJISTRI	LLOJI I LËNDËS
API (Ankesa penale të shkallës së tretë)	
PML (kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë penale)	Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë penale të cilën e parashtron pala apo prokurori
PZD (Zbutje e dënimit penal)	Kërkesë nga pala për zbutjen e dënimit
Rev I (Revizion I)	kërkesa për revizion nga pala e pakënaqur, ku gjykata e shkallës së parë është Gjykata Komunale
Rev II ( Revizion II)	Kërkesë për revizion nga pala e pakënaqur, ku gjykata e shkallës së parë është Gjykata e Qarkut)
CML (kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë civile)	Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë civile e parashtruar nga prokurori i shtetit
KML (kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundërvajtje)	Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundërvajtje e parashtruar nga prokurori
CPP (Përsëritje e procedurës civile)	Kërkesë e parashtruar nga pala për përsëritjen e procedurës civile
ERev (Revizion ekonomik)	Revizion për lëndë nga departamenti për çështje ekonomike
EML ( Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ekonomike)	Kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë për lëndë që vijnë nga Departamenti Ekonomik i Gjykatës së Apelit
ARJ (Rishqyrtim i jashtëzakonshëm administrativ)	Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm për lëndët administrative
APP (Rishikim i procedurës administrative)	Kërkesa nga pala për përsëritje të procedurës, kundër vendimeve të Gjykatës Supreme
AML (Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë administrative)	Kërkesa e Prokurorit të Shtetit kundër vendimit të Gjykatës Supreme për lëndë administrative
MGJ (Mbrojtje gjyqësore)	Kërkesa për mbrojtje gjyqësore administrative
ARev (Revizion administrativ)	Kërkesë për revision kundër vendimit të Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme, në bazë të ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat, nga Janari i vitit 2013 nuk do të merret më me lëndë të kësaj natyre:

REGJISTRI	LLOJI I LËNDËS
AP	Ankesë penale
PN	Propozim për vazhdimin e paraburgimit dhe ankesa kundër aktvendimit
APM	Ankesë panale për të mitur
AC	Ankesa civile
CN	Civile të nryshme
ADE	Delikte ekonomike
AE	Ekonomike
A	Administrative
AA	Ankesa Administrative
AN	Kërkesa për mbrojtje gjyqësore

### Lëndët gjatë këtij viti<sup>3</sup>

Gjatë këtij viti në Gjykatën Supreme prej viteve paraprake janë mbartur 3422 lëndë të lëmive të ndryshme.

Gjatë periudhës 1 Janar 2012 - 30 Dhjetor 2012, kanë ardhur 4212 të reja. Pra, gjatë këtij viti, në punë kanë qenë 7634 lëndë të lëmive të ndryshme.

Prej tyre, deri më 30 Dhjetor 2012 janë kryer 4036 lëndë.

Kanë mbetur edhe 3598 lëndë, prej të cilave deri më 30 Nëntor janë evidentuar 2146 lëndë, që sipas ligjit për gjykatat, do t'i hiqen nga kompetenca Gjykatës Supreme dhe do të kalojnë tek gjykatat tjera përkatëse

<sup>3</sup> Të dhënat janë nxjerrë nga regjistrat e Gjykatës Supreme

## Raporti i punës së Gjykatës Supreme të Kosovës

Më poshtë po e paraqesim raportin e punës së gjykatës në formë tabelare:

<b>RAPORTI I PUNES SE GJYKATES SUPREME PER PERIUDHEN 01. 01. 2012-30. 11. 2012</b>					
	Të mbartura	Të pranuar	Në punë	Të kryera	Të pakryera
AP (Ankesa penale)	359	594	953	665	288
PN (Propozim për vazhdimin e paraburgimit dhe ankesa kundër aktvendimit)	-	987	987	979	8
APM (Ankesë penale për të mitur)	-	21	21	19	2
API (Ankesa penale për shkallën e tretë)	9	10	19	10	9
PKL (Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë)	23	187	210	160	50
PZD (kërkesë për zbutje të dënimit)	3	99	102	93	9
AC (Ankesë civile)	40	78	118	102	16
Rev, Rev II (Revizion)	856	394	1250	447	803
KCRJ (Kërkesë civile për rishqyrtim të jashtëzakonshëm)	-	1	1	1	-
MLC (Mbrojtje e ligjshmërisë)	15	21	36	17	19
PPC (Përsëritje e procedurës civile)	12	17	29	27	2
CN (Civile të nryshme)	-	12	12	10	2
ADE (Delikte ekonomike)	-	-	-	-	-
AE (Ekonomike)	541	218	759	250	509
Rev E (Revizion ekonomik)	35	26	61	21	40
MLE (Mbrojtje e ligjshmërisë)	-	-	-	-	-
EN (Ekonomike të ndryshme)	-	12	12	11	1
A (Administrative)	1384	1419	2803	1131	1672
AA (Ankesa administrative)	136	107	243	84	159
KRjA (Kërkesë për rishqyrtim-administrative)	3	7	10	5	5
PPA (Përsëritje e procedurës administrative)	-	2	2	1	1
MLA (Mbrojtje e ligjshmërisë administrative)	2	-	2	2	-
A (Kërkesa për mbrojtje gjyqësore)	2	-	2	-	2
Rev A	2	-	2	1	1
<b>Gjithsejt</b>	<b>3422</b>	<b>4212</b>	<b>7634</b>	<b>4036</b>	<b>3598</b>

Duke i krahasuar këto të dhëna me vitin 2011, ku janë kryer 3012 lëndë deri më 13 dhjetor 2011 (kohë kur është përgaditur raporti për vitin 2011), del se këtë vit, gjatë së njëjtës periudhë, janë kryer rreth 700 lëndë më shumë.

Duhet theksuar se numrit prej 4036 të lëndëve të kryera, mund t'i shtohen edhe rreth 200 lëndë që pritet të kryhen deri në fund të vitit. Kështu që, numri i lëndëve të kryera për këtë vit, pritet të arrijë në rreth 4240.

Në bazë të rregullores së nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve<sup>4</sup>, gjyqtarët e Gjykatës Supreme, kanë arritur që gjatë vitit 2012 t'a përmbushin normën e kryerjes së lëndëve dhe në shumë raste edhe t'a tejkalojnë atë.

Kështu, gjatë këtij viti gjyqtarët e Gjykatës Supreme në bazë të raporteve për vlerësimin e tyre, kanë pasur një performancë mjaft të mirë.<sup>5</sup>

Gjithashtu, Gjykata Supreme ka arritur me sukses të reduktojë lëndët e vjetra, të grumbulluara nga vitet e mëparshme, duke u bazuar në strategjinë shtetërore për reduktimin e lëndëve të vjetra.<sup>6</sup>

---

<sup>4</sup> Rregullore për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve, KGJK, 01.01.2011

<sup>5</sup> Rregullore për vlerësimin e performances së gjyqtarëve, KGJK, 15.03.2012

<sup>6</sup> Strategjia shtetërore për zvogëlimin e lëndëve të vjetra të grumbulluara, KGJK, 18.11.2010

Në tabelat e mëposhtme janë të paraqitura të dhënat veq e veq për lëndët e natyrës penale, civile, ekonomike dhe administrative.

#### Të dhënat për lëndët penale:

<b>LENDET PENALE</b>					
<b>Periudha 01.01.2012 – 30.11.2012</b>					
	Të mbartura	Të pranuar	Në punë	Të kryera	Të pakryera
AP (Ankesa penale)	359	594	953	665	288
PN (Propozim për vazhdimin e paraburgimit dhe ankesa kundër aktvendimit)	-	987	987	979	8
APM (Ankesë penale për të mitur)	-	21	21	19	2
API (Ankesa penale për shkallën e tretë)	9	10	19	10	9
PKL (Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë)	23	187	210	160	50
PZD (kërkesë për zbutje të dënimit)	3	99	102	93	9
<b>Gjithsejt</b>	<b>394</b>	<b>1898</b>	<b>2292</b>	<b>1926</b>	<b>366</b>

#### Të dhënat për lëndët civile:

<b>LENDET CIVILE</b>					
<b>Periudha 01.01.2012 – 30.11.2012</b>					
	Të mbartura	Të pranuar	Në punë	Të kryera	Të pakryera
AC (Ankesë civile)	40	78	118	102	16
Rev, Rev II (Revizion)	856	394	1250	447	803
KCRJ (Kërkesë civile për rishqyrtim të jashtëzakonshëm)	-	1	1	1	-
MLC (Mbrojtje e ligjshmërisë)	15	21	36	17	19
PPC (Përsëritje e procedurës civile)	12	17	29	27	2
CN (Civile të nryshme)	-	12	12	10	2
<b>Gjithsejt</b>	<b>923</b>	<b>523</b>	<b>1446</b>	<b>604</b>	<b>842</b>

## Të dhënat për lëndët ekonomike:


<b>LENDET EKONOMIKE</b>					
<b>Periudha 01.01.2012 – 30.11.2012</b>					
	Të mbartura	Të pranuar	Në punë	Të kryera	Të pakryera
ADE (Delikte ekonomike)	-	-	-	-	-
AE (Ekonomike)	541	218	759	250	509
Rev E (Revizion ekonomik)	35	26	61	21	40
MLE (Mbrojtje e ligjshmërisë)	-	-	-	-	-
EN (Ekonomike të ndryshme)	-	12	12	11	1
ADE (Delikte ekonomike)	-	-	-	-	-
<b>Gjithsejt</b>	<b>576</b>	<b>256</b>	<b>832</b>	<b>282</b>	<b>550</b>

## Të dhënat për lëndët administrative:

<b>LENDET ADMINISTRATIVE</b>					
<b>Periudha 01.01.2012 – 30.11.2012</b>					
	Të mbartura	Të pranuar	Në punë	Të kryera	Të pakryera
A (Administrative)	1384	1419	2803	1131	1672
AA (Ankesa administrative)	136	107	243	84	159
KRjA (Kërkesë për rishqyrtim-administrative)	3	7	10	5	5
PPA (Përsëritje e procedurës administrative)	-	2	2	1	1
MLA (Mbrojtje e ligjshmërisë administrative)	2	-	2	2	-
A (Kërkesa për mbrojtje gjyqësore)	2	-	2	-	2
Rev A	2	-	2	1	1
<b>Gjithsejt</b>	<b>1529</b>	<b>1535</b>	<b>3064</b>	<b>1224</b>	<b>1840</b>



Për të pasur një pasqyrë më të qartë të natyrës së lëndëve që në bazë të të dhënave të mësipërme kanë ardhur në gjykatë, po i paraqesim këto të dhëna edhe në formë grafike:



Siç e theksuam edhe më lart, gjyqtarët e Gjykatës Supreme të të gjitha lëmive, kanë arritur që të plotësojnë normën e punës të vendosur në bazë të rregullores për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve dhe rregullores për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, e në shumë raste edhe t'a tejkalojnë atë.